

**AKT – THEMELIMI**  
**PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“UNREAL STUDIOS” SHPK**

Sot me datë 05.02.2024, z. Parim Bomova shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, lindur më 30.06.1998, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr.K1208190, me iniciativën e tij të lirë dhe duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil Shqiptar, dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, vendosi të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë:

**Neni 1**  
**Emërtimi**

Shoqëria emërtohet "UNREAL STUDIOS" Shpk (në vijim referuar edhe si "Shoqëria").

**Neni 2**  
**Forma ligjore**

“UNREAL STUDIOS” Shpk ështe një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar (në vijim referuar si "Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"), dhe në përputhje me këtë Statut.

**Neni 3**  
**Selia**

- 3.1 Në momentin e nënshkrimit të këtij Statuti, selia e Shoqërisë është në Tiranë, në adresën: Rruja e Kavajes, Garden Building ne kat te 23.
- 3.2 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.
- 3.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme/Ortakut të Vetëm, Shoqëria mund të ndryshojë selinë në pikën 3.1, të hapë seli të tjera operative, degë apo zyra përfaqesimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

**Neni 4**  
**Objekti i veprimitarisë**

Shoqëria ka si objekt të veprimitarisë së saj sa vijon:



- Projekte dhe studime urbanistike: projekte e ndërtimit civile, industriale turistike, bujqësore: studime ambientale dhe vlerësim të ndikimit në mjesht;
- Projekte interierësh dhe projektim Peizazhi e sistemimi;
- Studime e projekteve hidrogeologjik dhe gjeologjike,
- Projekte të rrugëve, urave, portave turistike: projekte të inxhinierisë elektrike, të inxhinierisë hidro-mekanike;
- Projekte konstruktive dhe supervizion punimesh e restaurime;
- Gjithashtu, Shoqëria mund të kryeje cdo lloj veprimtarie ekonomike apo transaksion tjetër që lidhet me konsulenca për aktivitetet e mësipërme të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotesimin e objektivit të Shoqërisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### **Neni 5 Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj për një periudhe kohore te pakufizuar.

### **Neni 6 Ortaku i Vetëm**

6.1 Ortaku i Vetëm themelues i Shoqërisë është:

- **Z. Parim Bomova** shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, lindur më 30.06.1998, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr.K1208190, **zotëruesh i 1 (një) kuote**, me vlerë ALL 100 (njëqind lekë) që përfaqëson **100% (njëqind përqind)** të **kapitalit** të Shoqërisë.
- 6.2 Ortaku i Vetëm përgjigjet për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulon personalisht humbjet e Shoqërise deri në pjesën e pashlyer të kontributiveve të nënshkruara. Kontributi i Ortakut të Vetëm/Ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë. Ortakët gjëzojnë kuotat e tyre në Shoqëri në përpjesëtim me kontributin e tyre në kapital.

### **Neni 7 Kapitali - Kuota**

7.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën ALL 100 (njëqind lekë)

7.2. Kapitali është i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale ALL 100 (njëqind lekë).



7.3 Kuota është e transferueshme në cdo kohë dhe mund të transferohet në përputhje me kushtet e parashikimet e legjislacionit në fuqi dhe ne përputhje me parashikimet në Statuin e Shoqërisë.

## **Neni 8** **Administrimi i Shoqërisë**

8.1 Shoqëria do të administrohet nga Administratoi i parë i vetëm i Shoqërisë:

- **Z. Parim Bomova** shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, lindur më 30.06.1998, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr.K1208190,  
i cili do të ketë këtë detyrë për një periudhe 5 (pesë) vjeçare.

8.2 Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) mund të shkarkojë Administratorin/ët në çdo kohë me shumicë të thjeshtë të votave pjesëmarrëse në votim nëse plotësohet kuorumi i vendosur në këtë statut.

## **Neni 9** **Kompetencat e Administratorit**

9.1 Veprimtaria tregtare e Shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrojë të gjitha kompetencat drejtuese të Shoqërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në si më poshtë vijon, me përjashtim të kompetencave që i takojnë Asamblesë së Përgjithshme, të parashikuara nga neni 81 të Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare:

- a) zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
- b) sigurimin e përpuesthshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe standardeve të kontabilitetit të Shoqërisë;
- c) kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
- d) mirëmbajtjen e rregullt të librave kontabël dhe dokumenteve financiare të Shoqërisë;
- e) përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
- f) kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
- g) thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme kur e vlerëson të nevojshme per mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;
- h) përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit përbledhës të Shoqërisë, raportin për ecurinë e Shoqërisë dhe ta paraqesë atë për miratim tek Asambleja e Përgjithshme, së bashku me propozimet për shperndarjen e fitimeve;"
- i) të punesojë ose të ndërpresë marrëdhëniet e punës me punonjësit sipas politikave të biznesit të Shoqërisë;
- j) kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligjin në fuqi si dhe në këtë Statut;



**Neni 10**  
**Audituesi Ligjor**

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm), kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël të Shoqerise, do t'i besohet një ose më shumë Audituesve Ligjorë.

**Neni 11**  
**Viti ushtrimor dhe pasqyrat financiare**

- 11.1 Viti ushtrimor i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.
- 11.2 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe i Audituesit Ligjor, nëse ka një të tillë, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Ligjin Per Tregtarët dhe Shoqëritet Tregtare.
- 11.3 Miratimi i dokumenteve në lidhje me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda gjashtë (6) muajve nga mbarimi i vtit finansiar.

**Neni 12**  
**Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë**

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqérohet me proceduren e likuidimit të saj.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një ose më shumë likuidatorë, dhe përcaktojë tagrat e tyre në përputhje me legjispcionin ne fuqi.
- 12.3 Me marrjen e vendimit për prishjen dhe likuidimin, Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik vetëm për nevoja të likuidimit deri në perfundim të këtij procesi.

**Neni 13**  
**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 14**  
**Dispozita të Përgjithshme**

- 14.1 Ky Akt për Themelimin e Shoqërisë ka si pjesë të saj edhe Statutin e Shoqërisë i cili bashkëlidhet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore në fuqi. Përsë nuk parashikohet në këtë Akt themeli, funksioni, rregullimi dhe organizimi i shoqërisë rregullohet sipas statutit të Shoqërisë.



- 14.2 Në rast të likuidimit përfundimtar të Shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi, pushon së vepruari edhe ky Akt Themelimi.
- 14.3 Ky Akt Themelimi perpilohet në 4 (katër) kopje origjinale, me vlerë të njejtë ligjore, në gjuhën shqipe, dhe nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me vullnet të lirë e të plotë.
- 14.4 Ortaku i Vetëm/Administratori i Shoqërisë do të regjistrojnë këtë Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe do të ndjekin të gjitha hapat e nevojshëm për regjisrimin e Shoqërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

\*\*\*\*\*

**Ortaku i Vetëm Themelues i Shoqërisë “UNREAL STUDIOS” Shpk**  
z. Parim Bomova

Parim Bomova   
Tiranë, datë 05.02.2024